

2014 Raporti Vjetor

mbi Gjendjen e Filantropisë

SHQIPËRIA

Pasqyrë e Fakteve

7.3%

Shkodër

34.1%

Tiranë

2.4%

Fier

2.4%

Gjirokastrër

2.4%

Durrës

7.3%


Elbasan

34.1%

Në të gjithë
Shqipërinë

9.8%

Jashtë
Shqipërisë



41

raste të
identifikuara



1.25
milion euro

Vlera totale e
donacioneve



0.45 €

Mesatarja e
donacionit për
qytetar




53.4%

rritja e dhurimit
nga individë/
masa

Gjatë vitit 2014, Catalyst Balkans ka monitoruar artikujt e mediave mbi filantropinë në Shqipëri të kryer nga individë, korporata dhe diaspora. Kjo broshurë paraqet statistikën bazë të gjetjeve gjatë hulumtimit.

DONATORËT

DONACIONET SIPAS LLOJIT TË DONATORËVE
(% e rasteve vs. % shumës së regjistruar)



GJETJET KRYESORE:



- Në vitin 2014, donatorët më aktivë ishin publiku i gjerë (31.7%), i ndjekur nga individët (19.5%) dhe sektori i biznesit (14.6%).
- Nëse shikojmë vlerën e donacioneve, pamja ndryshon: individët udhëheqin me 49.4% të vlerës totale të identifikuar, duke u ndjekur nga sektori i biznesit me 45.8%. Publiku i gjerë në këtë rast ndodhen shumë mbrapa me vetëm 4.0% të shumës totale të regjistruar.
- Nëse analizojmë dhurimet nga diaspora, përqindja e rasteve është 9.8% kurse vlera e identifikuar e donacioneve është 2.7%.
- Në tërësi, ashtu si edhe në shtetet e tjera, publiku i gjerë paraqet prezencën më të madhe, ndërsa përfshirja e individëve, si në përqindje por edhe në vlerën e identifikuar është jashtëzakonisht e lartë.



SEKTORI I BIZNESIT

Profilat e Llojeve më të Zakonshme të Donatorëve



**TOP 3
SUBJEKTET PRANUESE**

Institucionet

33.3%

Organizatat jo-fitimprurëse,
Qeveria Vendore/Qëndrore,
Individë/Familje

16.7%



**TOP 3
QËLLIMI I DHURIMIT**

Mbështetje për Grupet
e Margjinalizuara

50.0%

Mjedisore/Pastrim,
Katastrofat Natyrore /
Menaxhimi i Emergjencave

16.7%



**TOP 3 GRUPET
PËRFITUESE
PËRFUNDIMTARE**

Fëmijët/ Të Rinjtë pa
Përkujdesje Prindërorë

33.3%

Personat me Artesë të
Kufizuara, Popullsia e
Përgjithshme, Popullsia që
Jeton në Publiku i Gjerë të
tjera.

16.7%



SHEMBUJ NGA DONACIONET E SEKTORIT TË SEKTORIT TË BIZNESIT


Albania Mobile Communications (riemëruar si Telekom Albania në vitin 2015) kishte një fushatë interesante në Facebook për mbështetjen e organizatës ombrellë që punon me fëmijë dhe të rritur me Sindromin Down. Në faqen e Facebook-ut të AMCDSA, njerëzit mund të pëlqenin, komentnin apo ndanin këtë faqe. Për secilin nga këto veprime, AMC dhuronte një shume të caktuar për Fondacionin Shqipëtar të Sindromës Down: 500 pëlqime sollën 100 Euro; 500 komente sollën 100 Euro; dhe 500 ndarje të faqes, 250 Euro. Gjithsej, AMC dhuroi 12,000 Euro për Fondacionin, të cilat u përdorën për shërbime/terapi fizike dhe psiko-sociale për anëtarët e Qendrës Down Syndrome Albania.

Tri ndërmarje të vogla dhe të mesme u bashkuan për të siguruar mbështetje për organizatën jo-fitimprurëse Uniteti Mendo Pozitiv për të ridekoruar jetimoren "Zyber Hallulli". Deutschcolor siguroi ngjyrën, Mon Cheri dhe Goin C siguruan materialet e tjera të nevojshme, kurse Shop Taxi Care siguroi logjistiken dhe transportin.



PUBLIKU I GJERË

Profillet e Llojeve me të zakonshme të Donatorëve



SHEMBUJT E DONACIONEVE NGA PUBLIKU I GJERË




Studentët e departamentit të muzikës në Akademisë së Arteve në Tiranë nisën një fushatë për të zëvendësuar pianon e tyre të vitit 1966 me një piano të re, në mënyrë që ata të kenë një instrument të kualitetit më të lartë për t'u praktikuar. Publiku i gjerë dhe një numër individësh mbështetën fushatën duke mbledhur 35,000 EUR për pianon e re.

Për të katërtin vit rradhazi, Organizata jo-fitimprurëse Medical Response for the Diplomatic Corps, në bashkëpunim me Vodafone Albania, organizoi një maratonë. Të hollat e mbledhura gjatë maratonës ju dhuruan Spitalit Pediatric të Tiranës në mbështetje të trajtimit dhe kujdesit për fëmijët me leuçemi.

Një koncert i pazakontë u organizua në Tiranë, dhe i gjithë koncerti u performua në errësirë në shenjë solidariteti me personat më shikim të kufizuar dhe për të kuptuar përvojën e tyre. Fondet e mbledhura në koncert u përdorën për të mbështetur krijimin e një programi audio softuerik i cili do të përdorej nga persona të verbër dhe ata me të shikim të dëmtuar

INDIVIDËT

Profilat e Llojeve më të zakonshme të Donatorëve



SHEMBUJ TË DONACIONEVE INDIVIDUALE

Shqipëria ka prezence të pazakontë të donatorëve individ – në numrin e rasteve që janë identifikuar dhe në shumat e dhuruara – kur e krahasojmë me shtetet e tjera në rajon. Disa nga shembujt përfshijnë:

Eno Peci, një valltar i famshëm organizoi një show baleti dhe të gjitha të ardhurat që u grumbulluan i dhuroi për SOS Fshatrat e Fëmijëve në Tiranë.


Bashkim Qazimi, një biznesmen i njohur shpërndau ndihma familjeve në nevojë gjatë muajit të Ramazanit. Donacioni përfshinte pajisje si stufa elektrike dhe orendi (gjatë qilima).

Kristo Papa, kardiologu i njohur botërisht Shqiptar që punon jashtë vendit, në bashkëpunim me një Klinikë Zvicerane, ka ofruar ndërhyrje kardiologjike falas për fëmijët shqiptarë.

PËRDORIMI I DONACIONEVE

PËRDORIMI I DONACIONEVE
(sipas % së rasteve)

Të dhënat për Shqipërinë në lidhje me përdorimin e donacioneve tregojnë se 31.7% janë të orientuar drejt mbështetjes që mund të prodhojë efekte afatgjata (investime kapitale, pajisje, bursa për shkollim dhe te ngjashme si këto). Ky numër dhurimesh është deri në një masë më të lartë në krahasim me dhurimet në shtetet e tjera të rajonit. Një përqindje pak më e vogël prej 26.8% është e orientuar drejt dhurimit të njëhershëm (mbështetje humanitare, trajtim mjekësor për individë, shtëpi për individë). Sidoqoftë, kategoria më e madhe e donacioneve është klasifikuar si "të panjohura", pasi është e pamundur të kategorizohen, kryesisht për shkak të mungesës së të dhënave në artikujt e mediave dhe vështirësive për të konfirmuar mënyrën e shfrytëzimit të tyre nga faktorë relevantë. Sektori i biznesit, ashtu si edhe në shtetet e tjera, shfaqet me preference më të lartë për dhurime strategjike: 50% e donacioneve të tyre kanë efekte potenciale afatgjata.




SHEMBUJ TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE



Një fushatë për ngritjen e fondeve e ndërmarrë nga një numër partnerësh të sektorit të biznesit kanë ndihmuar ndërtimin e një qendre të re për personat me aftësi të kufizuara. Kjo qendër do të shërbejë si vendtakim për personat me aftësi të kufizuara duke ofruar shërbime të tilla si kurse kompjuterike ose gjuhësore, për të rritur mundësinë e punësimit të anëtarëve të qendrës.

Albanian Mobile Communications (më vonë e riemëruar si Telekom Albania) përgjatë vitit dhuroi një sasi të konsiderueshme të pajisjeve tek institucionet shëndetësore dhe arsimore në Shqipëri.

QËLLIMI I DHURIMIT



QËLLIME TË TJERA (sipas % së rasteve)

0 - 3%

- Menaxhimi i Emergjencave
- Dhurimet Sezonale

3 - 5%

- Edukim
- Infrastrukturë Publike


SHEMBULL



Është interesante të përmendet shembulli i dhurimit nga bizneset nën kategorinë e Menaxhimit të Emergjencave, veçanërisht sepse është një iniciativë rajonale e ndërmarrë në Shqipëri.

ProCredit Bank Shqipëri, së bashku me bankat ProCredit në Bullgari, Kosovë dhe Maqedoni, dhuruan 550,000 EUR në mbështetje të popullsisë së prekur nga përmytjet në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi. Donacioni u dhurua në formë e të mirave material si: medikamente, materiale sanitare, ujë, ushqim dhe furnizime të tjera për popullsinë në zonat e prekura.

SUBJEKTET PRANUESE

LLOJET E SUBJEKTEVE PRANUESE
(% e rasteve)

Në vitin 2014, pranuesit kryesorë të dhurimeve ishin institucionet qeveritare kryesisht institucionet e shërbimeve sociale. Individët dhe familjet radhitën në vendin e dytë. Organizatat jo-fitimprurëse ishin pranues të vetëm 4.9% të rasteve të identifikuar të dhurimeve.

Pranuesit shtetërorë përfshijnë institucionet vendore dhe/ose qendrore. 46.4% e rasteve të dhurimit janë regjistruar si dhurime ndaj shtetit, duke e bërë kështu shtetin si pranuesin më të madh të dhurimeve filantropike në Shqipëri.

Një shembull i mbështetjes së institucioneve arsimore vjen nga Fondacioni Mbretëresha Geraldinë, themeluar nga Princi Shqiptar Leka dhe e fejuara e tij Elia Zaharia. Ky fondacion mbështeti rinovimin e një numri të madh të shkollave në Shqipërinë veriore.

GRUPET KRYESORE PËRFITUESE

24.4%

FËMIJËT / TË RINJTË
PA PËRKUJDESJE
PRINDËRORE

14.6%

PERSONAT ME
VËSHTIRËSI
EKONOMIKE

14.6%

PERSONAT ME
PROBLEME
SHËNDETËSORE

12.2%

POPULLSIA E
PUBLIKU I GJERË

NDARJA E GRUPEVE TË TJERA (sipas % së rasteve)

Më pak se 5%

- Popullsia nga rajone gjeografike specifike

5 - 10%

- Personat me aftësi të kufizuara
- Personat që jetojnë jashtë vendit

Fëmijët dhe të rinjtë pa përkujdesje prindërore janë ndër grupet përfituese që janë mbështetur më tepër në Shqipëri gjatë vitit 2014. Donacionet kryesisht janë të drejtuara drejt jetimoreve shtetërore por gjithashtu edhe tek SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri. Disa shembuj të dhurimeve të bëra tek ky grup përfituesish përfshijnë:

Nga diaspora vjen një iniciative nga Zamira Qeraxhiu, koordinatore e Klubit Shqiptaro-Italian Lions. Ata organizuan një ekspozitë për të mbledhur fonde për rinovimin e jetimores “Zemër Nënë” në Gjirokastrë, e cila ka nën përkujdesje 450 fëmijë.

Shoqata Edukative-Kulturore ALSAR, që gjithashtu është një mbështetës afatgjatë i fëmijëve pa përkujdesje prindërore, ka ndërmarrë një iniciative të re në vitin 2014 – kurse të gjuhëve falas për fëmijët e jetimoreve në Tiranë. Kjo shoqatë planifikon të zgjerojë projektin duke përfshirë jetimoret e tjera në të gjithë Shqipërinë.

Stilistja, Luisa Spagnolli, në bashkëpunim me Ambasadën Italiane, ka hapur koleksionin pranverë/verë 2014 në Tiranë. Fondet e mbledhura nga ky event iu dhuruan jetimores shtetërore në Durrës.

Hulumtimi u krye nga:

°catalyst

Hulumtimi u mbështetet nga:

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

M
CHARLES STEWART
MOTT FOUNDATION

Raporti Vjetor i vitit 2014 mbi Gjendjen e Filantropisë në Shqipëri – Pasqyre e Fakteve – përpiluar nga Fondacioni Catalyst është pjesë e nje iniciative më të gjerë për të stimuluar filantropinë në rajon. Hulumtimet themelore dhe ky publikim zhvilluar bërë nga Fondacioni Catalyst (Catalyst Balkans) dhe me mbështetjen e pa hezitur të C.S Mott Foundation dhe Balkan Trust for Democracy (BTD).

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë ato të autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin apo reflektojnë qëndrimet e Balkan Trust for Democracy, German Marshall Fund of the United States apo të partnerëve të saj.

Duke marrë parasysh që vlera e donacioneve në Shqipëri është raportuar vetëm në 19.5% të rasteve, vlerësimi për vlerën totale të dhuruar është dhënë përmes ekstrapolimit duke u bazuar në të dhënat e që zotërojmë. Për më shumë informata, gjeni raportin e plotë në:

www.catalystbalkans.org

PËRGATITUR NGA:
Aleksandra Vesić

REDAKTORËT:
Aleksandra Vesić
Nathan Koeshall

Dizajni Grafik:
Tatjana Negić Paunović

CATALYST BALKANS
Takovska 38,
11000 Beograd
Serbi

www.catalystbalkans.org

Beograd, 2016